

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, përmes gjyqtarës Mevlide Shabani, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit Rr. H. nga Gjilani, Rr. "Prishtinës", ndaj të paditurës Spitali i Përgjithshëm në Gjilani, rr."Idriz Seferi" nr. 10, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sevdail Ahmeti nga Gjilani, me objekt kontesti pagesën e pagave me rastin e pensionimit, në seancën gjyqësore dhe publike të datës 16.07.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Rr. H. nga Gjilani, dhe **DETYROHET** e paditura Spitali i Përgjithshëm Gjilani, që paditësit t'ia paguaj tri paga për përcjellje në pension në vlerë prej 1,950.00 €, dhe tri paga për shpërblim jubilar në vlerë prej 1,950.00 €, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 3,900.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga marrja e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

1. Jurisdiksioni dhe kompetenca e gjykatës:

1.1. Fillimisht, gjykata shqyrtoi juridiksionin e kësaj çështje dhe bazuar në nenin 1, lidhur me nenin 29 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) si dhe nenit 11.1 të Ligjit për Gjykatat e Kosovës, çështja kontestimore bie nën juridiksionin e Gjykatës Themelore në Gjilani.

1.2. Kompetenca territoriale e gjykatës është përcaktuar konform nenit 49 të LPK-së, pasi që kontesti rrjedh nga mardhënia e punës, ku si paditës është punëtori, respektivisht puna është kryer apo është dashur të kryhet në territorin e Gjykatës Themelore në Gjilani.

1.3. Kompetenca lëndore është përcaktuar konform nenit 17.2, lidhur me nenin 29 të LPK-ës, pasi që vlerësimi i kompetencës bëhet në bazë të thënieve në padi dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura gjykata, meqenëse jemi para një kontesti me karakter civil që rrjedh nga marrëdhëniet e punës, gjykata çmon se është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e çështjes.

2. Rrjedha e çështjes dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse

2.1. Paditësi, Rr. H. nga Gjilani, fillimisht ka ushtruar padi në këtë gjykatë më datën 21.08.2017, ndaj të paditurave Shërbimi Spitalor Klinik Universitar me seli në Prishtinë dhe Spitali i Përgjithshëm Gjilani, me të cilën ka kërkuar që të obligohen të paditurat që paditësit t'ia paguajnë shumën në lartësi prej 3,900.00 euro, edhe atë për 3 (tri) paga në shumën prej 1,950.00 €, në emër të shpërblimit jubilar dhe për 3 (tri) paga në shumën prej 1,950.00 € në emër të kompensimit në emër të daljes në pension, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data 21.08.2017 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

2.2. Në seancën gjyqësore të mbajtur më datën 16.07.2018, paditësi ka bërë precizimin e padisë në kuptimin subjektiv në anën e palës së paditur, duke theksuar se e paditur duhet të jetë vetëm Spitali i Përgjithshëm në Gjilan, e jo edhe Shërbimi Spitalor Klinik Universitar.

2.2. Pas pranimit të padisë, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-ës, palës së paditur i ka dërguar aktvendimin për përgjegje në padi, në mënyrë që e njëjta të paraqesë përgjigje, ku nëpërmjet përfaqësuesit të saj në tërësi e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar duke shtuar se paditësi, kërkesën e vet e ka bazuar në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive edhe atë në nenin 52 dhe 53 e cila marrëveshje në mënyrë parimore e rregullon shumë çështje nga marrëdhënia e punës, por njëkohësisht ka obliguar sektor të ndryshëm që me kontratat e posaçme sektoriale t'i rregullojnë çështjet nga marrëdhënia e punës, posaçërisht ato që kanë implikime buxhetore. E në rastin konkret ka theksuar se Spitali i Përgjithshëm Gjilan nuk ka mjete të parapara e as të siguruara në buxhet për pagesën e këtyre mjeteve ashtu siç është kërkuar në padi dhe kërkesëpadi.

2.3. Paditësi, Rrahman Hajdari, si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe gjatë fjalës përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë kërkesëpadisë, duke i propozuar gjykatës që të njejtën t'a aprovoj në tërësi si të bazuar me ligj, ndërsa ka shtuar se te e paditura ka qenë në marrëdhënie pune deri më datën 09.10.2016, datë kjo sipas të cilës i është ndërprerë marrëdhënia e punës përshkak të pensionimit. Më tutje ka shtuar se pas marrjes së vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës me rastin e pensionimit, i njëjti i është drejtuar Këshillit Drejtues të Spitalit të Përgjithshëm në Gjilan që në bazë të kontratës Kolektive të Punës, t'ia paguajnë të pagat që i takojnë sipas ligjit si dhe Kontratës Kolektive me rastin e pensionimit, por se të njëjtit me vendimin numër 01-2139, të datës 22.12.2016, kërkesën e palës paditëse e kanë refuzuar si të pabazuar. Më pastaj, i pakënaqur me vendimin e Këshillit Drejtues të Spitalit të Përgjithshëm në Gjilan, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit për Ankesa të Spitalit të Përgjithshëm në Gjilan, të cilën ankesë ia kanë refuzuar si të pabazuar. Në fund ka deklaruar se paga e tij neto në memonetin e pensionimit ka qenë 650 € në muaj, ashtuqë ka kërkuar nga Gjykata që me rastin e marrjes së vendimit t'a detyroj të paditurën që paditësit t'ia paguaj shumën për tri paga jubilarë në vlerë prej 1.215.00 Euro, si dhe kompensimin për tri paga për përcjellje në pension shumën prej 1.215.00 Euro, në shumën 3,900.00 €, duke llogaritur 1,950.00 € për tri paga në emër të shpërblimit jubilar si dhe shumën prej 1,950.00 € në emër të kompensimit me rastin e pensionimit, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

2.4. Përfaqësuesi i të paditurës, Sevdail Ahmeti, si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe gjatë fjalës përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë përgjegjes në padi, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit t'a refuzoi si të pabazuar. I njëjti ka shtuar se sa i përket kërkesës së paditësit për pagat jubilarë, ka konsideruar se ato janë të ndara nga kompensimi me rastin e pensionimit të tri pagave, duke u bazuar në nenin 52 të Kontratës Kolektive, në të cilin nen është precizuar saktë se "shpërblimi jubilar paguhet në afat prej 1 muaji", e që në rastin konkret paditësi pasiqë i ka 35 vite përvojë pune, është dashur që kërkesën për kompensimin e pagave jubilarë, t'a bëjë atëherë kur i ka mbushur 30 vite përvojë pune, duke konsideruar se sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, kemi afatin e parashkrimit prej 3 vite.

3. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

3.1. Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: Vendimi mbi ndërprejen e marrëdhënies së punës përshkak të pensionimit, me numër 01-1425, i datës 13.09.2016; Kërkesa drejtuar Spitalit të

Përgjithshëm në Gjilan, me numër të protokollit 01/1941, e datës 08.11.2016; Vendimi me numër 01-2139, i datës 22.12.2016, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Gjilan; Ankesa me numër të protokollit 01/190, e datës 14.02.2017; Vendimi me numër 01-190, i datës 15.02.2017, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Gjilan dhe Lista e pagave për muajt korrik-gusht-shtator të vitit 2016.

4. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

4.1. Pas vlerësimit të provave të administruara si dhe provave të paraqitura, në kuptim të dispozitës së nenit 8 të LPK-ës, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike edhe atë: nga Aktvendimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, me nr. 01-1425, i datës 13.09.2016, gjykata vërtetoi faktin se paditësi për shkak të moshës së pensionit 65 vjeçare, i është ndërprerë marrëdhënia e punës që më datë 09.10.2016, e që në mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura edhe atë: ortoped – shef në Repartin e Ortopedisë deri më datë 09.10.2016, me një përvojë pune mbi 30 vite.

4.2. Nga Kërkesa drejtuar Spitalit të Përgjithshëm në Gjilan, me numër të protokollit 01/1941, e datës 08.11.2016, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kërkuar kompensimin e tri pagave mujore për përcjellje në pension, si dhe tri pagave mujore për shpërblim jubilar në mbeshtetje të kontratës kolektive dhe akteve tjera nënligjore.

4.3. Nga Pasqyra e listës së pagave për periudhën korrik-gusht-shtator 2016, gjykata vërtetoi faktin se paditësi për muajin korrik 2016, ka realizuar të ardhura në shumë prej 985.49 € neto, për muajin gusht i njëjti ka realizuar të ardhura në shumën prej 1,143.84 € neto, ndërsa për muajin shtator 2016, ka realizuar të ardhura në shumën prej 884.73 € neto;

4.4. Andaj, gjykata duke u bazuar në gjendjen faktike të shpjeguar si më lartë ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në ligj, duke u bazuar në dispozitën e nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit të Punës i cili ka qenë në fuqi në kohën e pensionimit të paditësit parashihet se *“Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënsin sesa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”*, poashtu në nenin 67 të këtij ligji parashihet se *“Kontrata e punës sipas fuqisë ligjore ndërpritet kur i punësuarit e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç”*. Poashtu në nenin 90 të këtij ligji parashihet se *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë oraganizata, marrëveshjen mund t’a lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve, dhe se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet dhe se Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozitat të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuara në këtë ligj”*, ashtuqë me të drejt nga provat e administruara u vërtetua se paditësi ka të drejtën e kompensimit të tri pagave për përcjellje në pension si dhe tri pagave për shpërblim jubilar duke u mbështetur në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës e cila ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2015, me të cilën shprehimisht është paraparë se *“implikimet financiare fillojnë të zbatohen që nga data 01.01.2015”*.

4.5. Poashtu në nenin 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës e cila ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2015, parashihet se i punësuar ka të drejtë në shpërblim jubilar dhe atë “ nënparagrafi 1.3. “ për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënsi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij, paragrafi 2 “*Punëdhënsi i fundit është ai që paguan shpërblimin jubilarë, ndërsa në nenin 53 të po kësaj Marrëveshje është paraparë se “ I punësuar, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt e fundit”*”.

4.3. Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës për bazën ligjore të Kontratës Kolektive e cila ka hyrë në fuqi në Janar të vitit 2015, ku kjo gjykatë erdhi në përfundim se Kontrata Kolektive e cila ka hyrë në fuqi në Janar të vitit 2015, paraqet bazë ligjore për themelësinë e kërkesëpadisë së paditësit, pasi që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive rregullon të drejtën në pension bazë dhe që Ligji i Punës i Kosovës, shprehimisht nuk parasheh me ndonjë dispozitë ligjore kompensimin e pagave dhe shpërblimin jubilar, me çka edhe rrjedhë përfundimi se kërkesëpadia e paditësit ka mbështetje ligjore dhe si e tillë është aprovuar si e bazuar në ligj.

4.4. Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me të cilin ka vendosur që secila palë t’i bart shpenzimet e veta procedurale, konform nenit 450 të LPK-ës.

4.5. Lidhur me propozimin e përfaqësuesit të të paditurës, për refuzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar nuk e aprovoi meqenëse i njëjti përpos që nuk ishte bindës dhe mjaftueshëm i argumentuar, nuk ishte në koherencë me asnjë nga provat e shtjelluara e të cilave kjo gjykatë i fali besimin.

4.6. Gjykata pati parasysh edhe provat e tjera të paraqitura në këtë proces, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për arsyetim të hollësishëm me rastin e vendosjes.

5. Dispozitat ligjore të aplikueshme

5.1. Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditësit, bazës juridike të padisë dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive konkretisht nenin 52 dhe 53, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës kontestimore në fuqi.

5.2. Gjykata shpenzimet e krijuara procedurale ua ngarkon të dy palëve ndërgjyqëse, konform nenit 450 të LPK-ës, meqenëse asnjëra nga palët ndërgjyqës nuk i kërkoi të njëjtat.

Nga arsyet e cekura më lartë e bazuar edhe në nenin 143 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjyqtarja,
Mevlide Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.